

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
 AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS-KOSOVSKA KATASTARSKA AGENCIJA

Nr./Br. 01/3712/20

Nr. i fq./Br. str. \_\_\_\_\_

Data/Datum: 09.12.2020

PRISHTINE-PRISHTINA



**Agjencia Kadastrale e Kosovës**  
**Kosovska Katastarska Agencija**  
**Kosovo Cadastral Agency**



REPUBLICA E KOSOVËS  
 REPUBLIKA KOSOVA  
 REPUBLIC OF KOSOVO

REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
 Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo  
 Ministria e Financave / Ministarstvo za Financie  
 Ministry of Finance

Administrata Tatimore e Kosovës / Porekska Administracija Kosova / Tax Administration of Kosovo

ARRIVA / ARHIVA / ARCHIVE

Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No. 09-06-4149

Nr. i fletëve / Broj stranica / No. pages: \_\_\_\_\_

Data / Datum: 09.12.2020

Hyresap PRISHTINE/A



ADMINISTRATA TATIMORE E KOSOVËS  
 PORESKA ADMINISTRACIJA KOSOVA  
 TAX ADMINISTRATION OF KOSOVO

## MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

NË MES TË

AGJENCISË KADASTRALE TË KOSOVËS

DHE

ADMINISTRATËS TATIMORE TË KOSOVËS

Prishtinë, Dhjetor 2020

Ky memorandum bashkëpunimi është përpiluar mbi bazën e konsultimeve, diskutimeve dhe angazhimeve konkrete të marra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Administrata Tatimore e Kosovës me qëllim krijimin e bashkëpunimit në mes palëve nënshkruese për qasjen në Regjistrin për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e më tejme si “RDPP”) përmes ueb shërbimeve.

Për sa i përket më sipër, palët bien dakord të respektojnë qëllimin e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit si më poshtë.

### **Neni 1**

#### **Palët**

1. Palët e këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, Agjencia Kadastrale e Kosovës (në tekstin e mëtejme si “AKK”) dhe Administrata Tatimore e Kosovës (në tekstin e mëtejme si “ATK”), nënshkruajnë këtë Memorandum në bazë të kompetencave të tyre sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi.
2. AKK nënshkruan këtë Memorandum Bashkëpunimi në bazë të nenit 4, të Ligjit Nr.04/-L-013 për Kadastër dhe dispozitave të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr.12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës.
3. ATK nënshkruan këtë Memorandum Bashkëpunimi në bazë të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L102 dhe Nr. 04/L-223 sipas të cilit është përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat Personale, Ligjit për Tatimin në të Ardhurat nga Korporatat, Ligjit për Tatimin në Vlerën e Shtuar dhe çdo legjislacioni tjetër të zbatueshëm në Kosovë, e që i ngarkon detyrën të administrojë çdo lloji tatimi.

### **Neni 2**

#### **Qëllimi**

1. Ky Memorandum ka për qëllim krijimin e bashkëpunimit në mes palëve nënshkruese për qasjen në Regjistrin për të Drejtat në Pronën e Paluajtshme (në tekstin e më tejme si “RDPP”) përmes ueb shërbimeve.
2. AKK dhe ATK do të krijojnë Procedura Standarde të Veprimit për ofrimin e shërbimeve ku edhe do të definohet lloji i shërbimeve në nivelin teknik.

### **Neni 3**

#### **Fushëveprimi**

1. Ky Memorandum vendos natyrën dhe nivelin e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet AKK-së dhe ATK-së.

2. Ky Memorandum po ashtu vendos procedurat, kushtet dhe kriteret për lehtësimin dhe shkëmbimin e informatave nëpërmjet kanaleve të sigurta ndërmjet AKK-së dhe ATK.

3. Dispozitat e këtij Memorandumi, duke respektuar po ashtu edhe kërkesat e tjera për informata shtesë, janë detyruese ndaj secilës palë në shkallën e arsyeshme dhe të zbatueshme duke i pasur parasysh kufizimet e tyre të burimeve.

#### **Neni 4 Përdorimi i të dhënave**

1. AKK përmes këtij Memorandumi vë në dispozicion të dhënat që posedon sipas bashkëpunimit të përcaktuar me këtë Memorandum dhe sipas legjislacionit në fuqi.

2. AKK lejon që përdorimi i të dhënave të mundësohet në nivel leximi, regjistrim të barrës tatimore dhe lirim të saj dhe printimi përmes ueb shërbimit, i cili është i qasshëm vetëm nga përdorues të autorizuar, me mundësi kërkimi për njësi kadastrale (parcelë, ndërtesë dhe pjesë të ndërtesës) dhe për person.

3. Të dhënat që do t'i shfrytëzojnë personat e autorizuar janë konfidenciale dhe do të përdoren vetëm për qëllime të kësaj marrëveshjeje dhe përmbushjes së obligimeve sipas legjislacionit në fuqi, vetëm për qëllime zyrtare.

4. Përdorimi i këtyre të dhënave për qëllime tjera konsiderohet si keqpërdorim dhe si i tillë do të sanksionohet sipas ligjeve të aplikueshme në Kosovë.

#### **Neni 5 Detyrimet e Agjencisë Kadastrale të Kosovës**

1. Për qëllimet e zbatimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, AKK:

1.1. Siguron qasje për të gjithë personat e autorizuar, për lexim dhe printim të informatave në RDPP, bazuar në nenin 24 dhe 26, të Ligjit Nr.04/-L-013 për Kadastër, nenit 17, paragrafi 1 dhe 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH - Nr.12/19 për ndarjen dhe regjistrimin e parcelës, si dhe zhvillon sistemin për regjistrimin e barrës tatimore dhe lirimin e saj online;

1.2. Ofron të dhënat nga RDPP përmes ueb shërbimeve duke shfrytëzuar bazën elektronike të sistemeve digjitale;

1.3. Cakton një zyrtar i cili do të jetë pikë kontakti mes palëve nënshkruese të këtij Memorandumi;

1.4. Ofron trajnim për zyrtarët të cilët do të kenë qasje në RDPP përmes ueb shërbimeve;

1.5. Nxjerr raporte për shërbimet e dhëna (javore, mujore, vjetore) sipas kërkesës;

1.6. Fatura për shërbimet e dhëna do të lëshohet në fund të çdo muaji kalendarik dhe mund të dërgohet në formë elektronike ose të merret në letër në AKK deri sa nuk ndryshohet

legjislacioni ne fuqi qe rregullon çështjen e pagesave dhe tarifave për shërbimet qe ofron AKK, me theks te veçantë për ATK.

1.7. Harton dokumentin “Marrëveshja e nivelit të shërbimit” si udhëzues për mënyrën e përdorimit të ueb shërbimeve si dhe llojet e shërbimeve që do të ofrohen;

1.8. Siguron që të dhënat që i ofron do të jenë të përditësuara dhe të qasshme në çdo kohë.

## **Neni 6**

### **Detyrimet e Administratës Tatimore të Kosovës**

1. Për qëllimet e zbatimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit, ATK:

1.1. Ofron në dispozicion të AKK-së listën e personave të autorizuar të cilët do të kenë qasje në RDPP përmes ueb shërbimeve;

1.2. Kryen përgatitjet teknike të nevojshme për qasje dhe regjistrim të ngarkesave në RDPP përmes ueb shërbimit;

1.3. Cakton një zyrtar kontaktues sa i përket kërkesave për hapjen/mbylljen e llogarive të përdoruesve, mbikëqyrjen e sigurisë dhe çështjeve tjera të lidhura me qasjen dhe përdorimin e të dhënave përmes ueb shërbimeve nga RDPP.

2. Personi i autorizuar nga ATK obligohet të:

2.1. ruaj fshehtësinë dhe të mbajë të sigurta të dhënat e marra-shikuara nga RDPP dhe

2.2. mbajë evidencën e raporteve të punës në sistemin e AKK-së.

## **Neni 7**

### **Kushtet Financiare**

Zbatimi i këtij Memorandumi nuk krijon obligime shtesë financiare për palët. Sidoqoftë, në rast të shpenzimeve eventuale, secili institucion, në mënyrë të pavarur, do të mbulojë koston financiare për realizimin e këtij Memorandumi për Bashkëpunim, përveç nëse nuk është përcaktuar ndryshe me ndonjë dispozitë të veçantë.

## **Neni 8**

### **Zbatimi**

1. Palët pajtohen se do të kujdesen për zbatimin me përkushtim dhe përpikmëri të këtij Memorandumi.

2. Modalitetet e ofrimit të të dhënave do të përcaktohen më në detaje në mes AKK-së dhe ATK-së pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, përmes grupeve teknike të themeluara në mes të dy institucioneve, duke marrë parasysh kërkesat e të dy palëve për sigurinë e parandalimit të keqpërdorimit të të dhënave.

## Neni 9

### Fillimi, zgjerimi dhe mbarimi i bashkëpunimit

1. Memorandumi do të jetë në fuqi nga data e nënshkrimit deri në përfundim ose deri sa të zëvendësohet nga ndonjë memorandum ose instrument tjetër.
2. Përveç fushave të bashkëpunimit të përcaktuara në këtë Memorandum, palët mund të pajtohen në çdo kohë që të zgjerojnë bashkëpunimin e tyre në fusha të tjera që janë në kuadër të kompetencave të tyre ligjore.
3. Memorandumi mund të përfundohet nga secila Palë duke njoftuar paraprakisht me shkrim tridhjetë (30) ditë më herët, ndërsa mund të plotësohet dhe ndryshohet vetëm pas marrëveshjes me shkrim nga të dyja Palët.
4. Në rast të përfundimit procedurat, kushtet dhe kriteret lidhur me përdorimin dhe shpërndarjen e informatave të shkëmbyera sipas këtij Memorandumi vazhdojnë të jenë në fuqi dhe janë detyrues për Palët sa i përket informatave të marra nga Pala tjetër sipas këtij Memorandumi para përfundimit.
5. Palët pajtohen që çdo mosmarrëveshje apo keqkuptim ta zgjidhin me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë si dhe bazuar në ligjet në fuqi.

## Neni 10

### Hyrja në fuqi dhe nënshkrimi

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi nënshkruhet për një kohë të pacaktuar, ndërsa hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
2. Memorandumi i Bashkëpunimit është i përgatitur në gjuhën shqipe, në 2 (dy) kopje origjinale, nga 1 (një) kopje origjinale për secilën palë.

Data dhe vendi i nënshkrimit të këtij Memorandumi të Bashkëpunimit:

**Palët nënshkruese**

**Avni Ahmeti**  
  
Drejtor Ekzekutiv



**Ekrem Hyseni**  
  
u.d. Drejtor i Përgjithshëm

